



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 01-988/15
Nr. i faq. 03
Broj stranica 03
Nr. pages 03
Data Datum Date 01.04.2015
PRISHTINE

DATË/A:	30/03/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Bexhet ASLLANAJ u.d Drejtor i Prokurimit – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
CC:	z. Eliana NAKA Sekretare e Përgjithshme – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve teknologjike”

I nderuar z. ASLLANAJ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve teknologjike” me numër prokurimi: MTI204/15/013/221 , Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: “Mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve teknologjike” me numër prokurimi: MTI204/15/013/221, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Për rastin me nr. protokoli: DPKPP 03-03-825/15

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, bazuar në nevojën për mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve teknologjike, ka paraparë aktivitetet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, është shpallur më datë: 18/03/2015.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjatë përpilimit të dosjes së tenderit të lartë cekur nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me ligjin e Prokurimit Publik.

Në “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve teknologjike”, Autoriteti Kontraktues tek pika III.2 Kushtet për pjesëmarrje, nënpika III.2.3, Kapaciteti Ekonomik Financiar është kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë periudhës së fundit (2012-2014) ka qenë prej jo më pak se 50,000.00 Euro” Autoriteti Kontraktues me kërkesën për qarkullim prej 50,000.00 € ka kaluar kufizimin sipas UA-02/2014. Udhëzimi përkufizon se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar e cila nuk duhet të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të Projektit. Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të operatorëve ekonomik të rinj dhe të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të rinj të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme mundësitë ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Në “Njoftim për Kontratë” Autoriteti Kontraktues tek pika III.2 Kushtet për pjesëmarrje, nënpika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional është kërkuar që: “Lista e kontratave së paku 2 kontrata për punë të ngjashme të realizuara me institucione publike të përcjellura me referenca për kontratat e njëjta”. Autoriteti Kontraktues duhet që kontratat për punë të ngjashme të kërkojë në tre vitet e fundit, gjithashtu nuk mund të kërkojë që kontratat t'i jenë të realizuara vetëm me institucionet publike. Kufizimi që punët e ngjashme të jenë vetëm me institucionet publike, është kriter diskriminues, i cili favorizon Operatorët Ekonomik që kanë realizuar kontratat me institucionet publike, në ndërkohë Operatorët Ekonomik që nuk kanë realizuar kontrata të tilla nuk mund të ofertojnë në këtë aktivitet prokurimi.

Në “Njoftim për Kontratë” Autoriteti Kontraktues tek pika IV Procedura, nënpika IV.3.5 A është e nevojshme siguria e tenderit, vlera e sigurisë së tenderit është kërkuar shuma prej 2,000.00 €. Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se tre për qind dhe jo më shumë se pesë për qind e vlerës së parashikuar të kontratës publike. Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk është brenda këtij kufizimi ligjor.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit, si dhe Nenin 57 Sigurimi i Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Pikën 23, Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik si dhe Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014..

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues anulimin e këtij aktiviteti të prokurimi. Në rast të Ri Tenderimit, të përpilohet Dosja në mënyrë më të përshtatshme duke u bazuar në rekomandimet që dalin nga ky Opinion i Agjencisë, për të mos i lënë hapësirë tendencave manipuluese nga Operatorët Ekonomik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

KOSOVO